



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:105652
Datë: 30.01.2025
Numri i dokumentit: 06777021

P.nr.297/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM- Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi Muçaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit M.N, me vendbanim në fshatin Komuna e Pejës, i akuzuar për veprën penale “*Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge*” nga neni 269 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjën PP/II.nr.2618/23, të datës 03.04.2024, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar publik të datës 28.01.2025 të mbajtur në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj dhe të pandehurit M.N, me datën 30.01.2025, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 30.01.2025, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

M.N, i lindur më datë, në Pejë, me vendbanim në fshatin rr. “.....” ..,, në Komunën e Pejës, nga babai V. dhe nëna V2., e gjinisë, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion, i gjendjes së mesme ekonomike, i njohur me numër personal, me nr. të tel., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, **mbrohet në liri.**

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Më dt. 25.12.2023, rreth orës 21:35 në rr. e Bjeshkës së Lipës, me qëllim të konsumimit, pa autorizim ka poseduar narkotikë, në atë mënyrë, që i pandehuri nga persona deri me tani të pa njohur, është furnizuar me substancë narkotike të llojit "Marihuanë" me peshë neto prej 1.98 gram, e ku kjo substancë është gjetur dhe konfiskuar natën kritike nga patrulla e policisë në vendin e lartcekur, ku pas kontrollimit që i është bërë veturës, pikërisht nën ulëse ku ishte ulur i pandehuri, është gjetur një qese e mbushur me Marihuanë, të cilët e kishte në lënë i pandehuri,

- Me çka ka kryer veprën penale "**Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge**" nga neni 269 parag. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në mbështetje të nenit 1, 4, 7, 8, 9, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 47, 48, 49, 50, 69, 70, 71, 72 dhe 269 par.1 të KPRK-së, dhe neneve 242, 277, 364, 449, 450, 452 dhe 460 të KPPRK-së, të akuzuarin e:

GJYKON

- I. Me **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej gjashtëqind (600) euro, të cilin dënim i pandehuri obligohet të e paguaj në afat prej tre (3) muajsh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Si dhe me **DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, e i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit prej dy (2) vitesh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.
- III. Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën të cekur si më lartë brenda afatit të lartcekur, gjykata konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, gjykata do të e zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burgim, ku njëzetë (20) euro, gjobë llogaritet barabartë

me një (1) ditë burgim. Nëse i pandehuri e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet.

- IV.** Nëse i pandehuri gjatë periudhës së verifikimit të përcaktuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, kryen veprë tjetër penale, dënimi i kushtëzuar në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, do të revokohet dhe do të ekzekutohet dënimi me burgim.
- V.** **OBLIGOHET** i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej tridhjetë (30) euro, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej njëzetë (20) euro, e të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- VI.** Konform nenit 269 par.3, të KPRK-së, **KONFISKOHET** - substanca narkotike e llojit marihuanë, në peshën neto 1.98 gram të sekuestruara përkohësisht në bazë të vërtetimit mbi sekuestrimin e përkohshëm të dt. 25.12.2023, me nr. të rastit, dhe të njëjtat pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, urdhërohen që të shkatërrohen sipas procedurave standarde ligjore.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, me datë 03.04.2024 ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.2618/23, ndaj të pandehurit M.N, për shkak të veprës penale “*Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge*” nga neni 269 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancën fillestare me datë 28.01.2025, e cila u mbajt në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj dhe të pandehurit M.N.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit PP/II.nr.2618/23, të datës 03.04.2024, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe tutje ka udhëzuar të pandehurin për kushtet, benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, dhe pasi që i pandehuri M.N, ka deklaruar që i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë të njëjtit i është dhënë mundësia që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë me

ç'rast i njëjti me vullnet e vetëdije të plotë ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cilat i vihet në barrë, se ndihet i penduar dhe premtan se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tjera penale.

Andaj, gjykata ka marrë mendimin e palëve në procedurë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, me ç'rast Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.*

Në vijim, gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në raport me dispozitën ligjore të nenit 242 par. 2 nën par. 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPPRK-së, dhe gjeti se në rastin konkret të gjitha këto kushte janë përmbushur në mënyrë kumulative.

Kjo për faktin se gjykata ka gjetur se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, një pranim i tillë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarit, e që pranimi i fajësisë nga ana e tij po ashtu gjen mbështetje edhe në provat materiale siç janë: *raporti i oficerit policor L.E, i përpiluar më datë 25.12.2023; deklarata e të pandehurit e dhënë në polici me datë 25.12.2023; deklarata e dëshmitarit e dhënë në polici më datë 25.12.2023; vërtetim mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve dt. 25.12.2023; lista e dëshmive; fotografitë e substancave narkotike; raporti i ekspertimit të narkotikut i dt. 05.03.2024.* Po ashtu, gjykata ka gjetur se aktakuza në fjalë nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, ashtu që konform dispozitës së nenit 242 par. 6 të KPPRK-së, ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Pasi që palët njëzëri kanë deklaruar se nuk propozojnë që të caktohet seanca e posaçme për matjen e dënimit e paraparë me nenin 356 par.1 të KPPRK-së, gjykata ka vazhduar seancën me shqiptimin e dënimit duke i ftuar palët që të deklarohen lidhur me rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

Prokurori i shtetit Ermal Demhasaj, ka deklaruar se: *në kuptim të rrethanave rënduese i propozoj gjykatës që të marrë parasysh ndonjë dënim eventual të mëparshëm, ndërkaq si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë.*

I pandehuri M.N, ka deklaruar se: *jam penduar për veprën penale që kam kryer, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, shpreh keqardhje.*

Me faktet e ofruara ne shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “*Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge*” nga neni 269 par.1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryej në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryera dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë i pandehuri është i vetëdijshëm për veprën e kryer penale dhe gjykata e ka vërtetuar se e ka kryer me dashje.

Gjyqtarja e vetme gjykuese në bazë të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë, ka shprehur keqardhje, është penduar për veprën penale të cilën e ka kryer dhe premtimin që i njëjti në të ardhmen nuk do të përsërisë sjellje të tilla, ndërkaq Gjykata, si rrethana rënduese përtej figurës së veprës penale gjeti.

Andaj, gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të pandehurit e gjykoi si në dispozitivin e I të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë së tij penale dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale, konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi shqiptimin e dënimit me kusht, si në dispozitivin e II të këtij aktgjykimi u mor në përputhje me nenin 48 par.1 dhe 2, e lidhur me nenin 49 par.1, dhe par.4 të KPRK-së, e po ashtu me nenin 269 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas të cilit është parashikuar se formën themelore të

veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge e kryen: *“Kushdo që pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet”.*

Ndërkaq, në dispozitën par.1 të nenit 49, që i referohet kushteve mbi shqiptimit e dënimit me kusht përcaktohet se: *“Dënimi me kusht mund t'i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet”*, ndërkaq në par.4 përcaktohet se: *“Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me kusht, gjykata merr posaçërisht parasysh qëllimin e dënimit me kusht, sjelljen e mëparshme të kryesit, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrethanat e tjera në të cilat është kryer vepra penale”.*

Ndërsa sipas par.5 të nenit 49 të KPRK-së, i cili përcakton se: *“Kur gjykata shqipton dënimin me burgim dhe dënimin me gjobë, gjykata mund të shqiptojë dënimin me kusht për të dy këto dënime ose vetëm për dënimin me burgim”*, gjykata ka shqiptuar dënim me kusht vetëm sa i përket dënimit me burgim. Tërheqja e vërejtjes të pandehurit se nëse në periudhën verifikuese prej dy (2) vitesh do të kryej vepër tjetër penale ndaj tij do të ekzekutohet dënimi me burgim si në dispozitivin e këtij aktgjykimit, është një paralajmërim serioz që i njëjtit të parandalohet në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Vendimi për zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim burgimi nëse i pandehuri dështon, refuzon apo nuk dëshiron ta paguaj dënimin e shqiptuar me gjobë si në dispozitivin III të këtij aktgjykimi është marrë konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi për revokimin e dënimit me kusht nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit kryen vepër tjetër penale, është marrë konform nenit 50 par.2 të KPRK-së, andaj ka vendosur si në pikën e IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi si në pikën e V të dispozitivit të këtij aktgjykimi lidhur me kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2, nën par. 2.1 dhe nën par. 2.6, të KPRK-së, ndërsa konform nenit 36 par.1, 2, 3, nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin si në pikën VI të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e mori duke u bazuar në dispozitat e nenit 269 par. 1 të KPPRK-së, lidhur me nenin 269 par.3, të KPRK-së, me ç'rast, 1.98 gram substancë narkotike e llojit marihuanë, të sekuestruara me vërtetimin për sekuestrim të përkohshëm të datës, me nr. të rastit, janë konfiskuar dhe pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, do të behët shkatërrimi i tyre.

Nga sa u tha më lartë, e në kuptim të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.297/24, me datë 30.01.2025.

Bashkëpunëtorja profesionale

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Leonita Lajçi Muçaj

Blerta KERMENDI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.